

TËRMETI NË SHQIPËRI

6.4 Rihter

GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË SITUATËS PAS TËRMETIT TË 26 NËNTORIT 2019

Tërmeti i 26 nëntorit 2019 krijoi një situatë emergjente për të gjithë banorët në zonat e prekura. 51 persona humbën jetën, 1 mijë njerëz u plagosën dhe 14 mijë persona u zhvendosën përkohësisht. Thumana, Durrësi, Kurbini, Lezha dhe Kamza ishin zonat më të prekura.

Në këtë situatë, krahas ndërhyrjes së menjëhershme të World Vision për nevojat më emergjente, duhet krijuar një pamje e qartë e nevojave të familjeve. Për këtë arsye, World Vision Albania ndërroi një Vlerësim (raport) të Shpejtë të situatës pas tërmetit. Ky vlerësim është një fotografim i shpejtë, i përqëndruar i situatës. Ai siguron informacion në lidhje me tendencat e nevojave dhe kushtet në të cilat ndodhen komunitetet.

Problemet më të shpeshta që kanë raportuar të intervistuarit janë: shtëpitë e dëmtuara; problemet shëndetësore, sidomos ato të shëndetit mendor pas traumës tek fëmijët dhe të rriturit; jetesa dhe të ardhurat; edukimi; uji dhe ushqimi; mbrojtja dhe informimi.

Strehim



Për 85% të banorëve të prekur nga tërmeti, strehimi është shqetësimi parësor. Bashkia e Kurbinit spikat me përqindjen më të lartë të banorëve (94%) që shprehin këtë si shqetësimin e tyre kryesor.

75% e familjeve të prekura që jetojnë në çadra nuk iu plotësohen nevojat thelbësore të ngrohjes.

Familje që nuk arrijnë të plotësojnë nevojat bazë për artikujt e mëposhtëm:

- 25.4% pajisje ngrohëse (kryesisht në tenda)
- 23.1% sapunë, furça dhëmbësh, produkte higjienike dhe produkte të tjera personale
- 20.9% veshje dhe këpucë
- 20.4% dyshekë
- 19.2% batanie
- 17.8% kova dhe legenë

Shëndet



81% e të rriturve dhe 74% e fëmijëve

shfaqin shenjat e stresit pas traumës (përfshirë këtu pagjumësi, frikë, ankth dhe humbje oreksi).

Simptomat e traumës dhe stresit janë më të theksuara tek banorët që jetojnë në:

- 88.4% çadra,
- 85.2% shtëpi të dëmtuara,
- 61.1% të strehuar në hotele.
- 59% Simptomat e sëmundjeve fizike (si ethe, dhimbje koke) janë më të shpeshta tek pjesa e popullsisë së strehuar në çadra dhe në banesat e dëmtuara.

Edukim



41% e prindërve janë të shqetësuar për sigurinë fizike të shkollave në katër zonat e prekura.

Të ardhura



Edhe pse tërmeti nuk preku në mënyrë të konsiderueshme jetesën dhe të ardhurat në zonat rurale, familjet e prekura nga tërmeti raportojnë që po jetojnë në varfëri. Jetesa dhe të ardhurat e familjeve sigurohet nga:

- 32.1% Pagat
- 31.9% Pension
- 18.2% Punë rastësore (informale)
- 17.6% Ndhimja ekonomike
- 9.4% Borxhe dhe kredi
- 7.6% Ndhimja e aftësisë së kufizuar
- 7.2% Prodhim / shitje të produkteve bujqësore
- 6.7% Biznese të vogla
- 5.7% Remitanca

Ushqim/Ujë



- 37% e të intervistuarve që nuk punojnë nuk mund të sigurojnë ushqim;
- 30% kanë sjellë si shqetësim urinë;
- 28% e tyre nuk kanë ushqim të mjaftueshëm.
- 38% e të intervistuarve thonë se uji nuk është i mjaftueshëm.

Informim/Mbrojtje



- 44.2% e banorëve në zonat rurale nuk kanë informacione të mjaftueshme për shërbimet mbështetëse që janë vënë në dispozicion për të dëmtuarit pas tërmetit. Kamza kryeson listën me 58% të të anketuarve.
- 51% e fëmijëve identifikohen si grupi më i cënuar ndër popullatën e prekur nga tërmeti (sipas pohimeve të prindërve).

2460 511

Kampioni i intervistuar u përbë nga 2460 individë, në N=511 familje në 4 zona të dëmtuara nga tërmeti (Durrësit, Kamzës, Kurbinit dhe Lezhës). 60% (n=291) e familjeve të intervistuar jetonin në banesa në pronësi të tyre, por të dëmtuara nga tërmeti. 22% (n=112) jetonin në hotele dhe pjesa tjetër 18% (n=108) në çadra apo mjedise të tjera të improvizuara për banim.

Të dhënat sasore u mblodhën përmes instrumentit të përdorur nga World Vision International në vlerësime në situata emergjente, Basic Rapid Assessment Tool (BRAT), i përkthyer në gjuhën shqipe. Mbledhja e të dhënave u realizua në datat 4-7 dhjetor 2019, duke përdorur platformën KoBo collect.

Kush jemi ne:

World Vision është një organizatë e krishterë, humanitare, zhvillimi komunitar, dhe advokative. Rreth 50 mijë fëmijë përfitojnë çdo vit nga programet e World Vision Albania në 25 bashki. Në Shqipëri, World Vision njihet në komunitet si mobilizues dhe ndërlikohës i tyre me institucionet dhe organizatat për çështje që prekin jetën e fëmijëve.

Gjatë kësaj periudhe kemi bashkëpunuar me 56 organizata, 18 kisha dhe organizata me bazë besimi.

* Raporti synon të nxjerrë në pah nevojat e familjeve të prekura nga tërmeti duke i dhënë zë problematikave të prioritetuara prej tyre. Krahas problemeve ata kanë sugjeruar zgjidhjet më të përshatshme për situatën në të cilën ndodhen.
** Audiencia e interesuar ndaj këtij raporti është e lirë të marrë në konsideratë rekomandimet e propozuara.

Harta

